

Krerët e komunave kërkojnë që të lirohen nga ndërhyrjet e nivelit qendror

Komunat duan pavarësi nga qendra

Përfaqësuesit e komunave kërkojnë që të jenë të pavarur nga qendra ashtu siç është e nënshkruar në Kartën Evropiane të Vetëqeverisjes Lokale. Asociacioni i Komunave të Kosovës ka kërkuar që granti i përgjithshëm prej 10% të mos ulet në 8% dhe që AKK-ja të jetë në komisionin e granteve



Mendohije Krelani

mendohije.krelani@gazetatribuna.com

Prishtinë, 22 mars - Krerët e komunave konsiderojnë se nuk kanë autonomi mbi vendimmarrjet financiare dhe strukturat e stafit, ashtu siç parashihet edhe më Kushtetutën e Kosovës. Rrjedhimisht, sipas tyre, komunat në Kosovë nuk janë të pavarura, por kufizohen nga niveli qendror. Nisur nga kjo, ata insistojnë që komunat të veprojnë ashtu sikurse është e nënshkruar edhe në Kartën Evropiane të Vetëqeverisjes Lokale. Për t'u eliminuar këto probleme, Asociacioni i Komunave të Kosovës, ka marrë iniciativën të kërkojë ndryshimin e Ligjit mbi Financat Lokale. Një kërkesë e tillë bazohet edhe në analizimin e propozimeve të FMN-së në lidhje me financat e qeverisjes lokale. Sazan Ibrahim, drejtor ekzekutiv i AKK-së, ka thënë se padrejtësia më e madhe është insistimi që 10% e shumës totale të grantit qendror, të ulet në 8%. "Këtu dëmtohet direkt qytetari i Kosovës, sepse komunat edhe ashtu i kanë buxhetet e vogla dhe të hyrat vetanake nuk i kanë gjithmonë të sigurta", ka thënë ai. Me ndryshimin e ligjit, AKK-ja pos që ka kërkuar të jetë pjesë e Komisionit për ndarjen e granteve, ka insistuar po ashtu që komisioni të përbëhet nga 7 kryetarë të komunave, e jo nga 4 siç është tani. "Tani ky komision përbëhet në bazë të sistemit të lotarisë. Zgjidhen katër

"Padrejtësia më e madhe është insistimi që 10% e shumës totale të grantit qendror, që çdo vit ndahet për komuna, të ulet në 8%. "Këtu dëmtohet direkt qytetari i Kosovës", ka thënë Sazan Ibrahim, drejtor ekzekutiv i AKK-së

kryetarë me kriteret e Ministrisë së Financave", ka thënë Ibrahim. Gjithashtu, AKK-ja, sipas tij, ka kërkuar që investimet kapitale prej nivelit qendror nëpër komuna, të shpërndahen në mënyrë më të drejtë, "Duke u paraprirë nga studimet e fizibilitetit, për të marrë për bazë nevojat e komunave dhe kost-benefitin e këtyre investimeve", ka thënë Sazan Ibrahim.

Mst: Komunat, të pakënaqura për uljen e granteve nga 10% në 8%, nuk pajtohen as krerët e komunave. Qemajl Mustafa, kryetar i Gjilanit, ka thënë se grantet duhet të jenë edhe më të larta. "Ne kërkojmë që formulat për grante për komunat të rindërtohen, sepse nuk janë në harmoni me nevojat përherë në rritje të komunave tona", ka thënë ai. Investimet kapitale, sipas tij, duhet të ndahen më shumë nëpër komuna. "Duhet të jetë një formulë e saktë, e bazuar në numrin e pop-

ullsisë, në territorin dhe në ndonjë specifikë tjetër që e kanë komunat", ka thënë ai. Edhe kryetari i Deçanit, Rasim Selmani, ka deklaruar se ndarja e granteve është e gabuar në gjithë Kosovën. Ndarja në bazë të numrit të popullsisë, sipas tij, nuk është e saktë. "Kjo ishte dashur të rritej e jo të zvoglohej. E sa i përket granteve, mendoj që nuk ka një ndarje të drejtë të tyre", ka thënë ai.

AKK-ja s'mund të jetë në komisionin e granteve

Ramadan Avdiu, zv/ministër i Financave, ka pohuar se Komunat janë të përfaqësuara në Komision të Granteve. "Çdo komune do t'i vijë rendi, sepse kjo shkon me rrotacion, nga 4 kryetarë të komunave janë për çdo vit", ka thënë ai. Mirëpo, sipas tij, Asociacioni i Komunave nuk mund të jetë pjesë e Komisionit. "Asociacioni është OJQ dhe nuk mund të jetë në Komision", ka thënë ai. Kurse sa i përket 10 përqindëshit, ai ka thënë se kjo do të varet nga vendimi që do ta marrë Kuvendi i Kosovës. Sipas tij, të gjitha kërkesat, propozimet, sugjerimet do të merren parasysh nga ministria. "Në fund, pasi të draftohet ligji, shkon në Kuvend dhe ashtu siç do të aprovohet, 10% apo edhe më shumë, ne edhe do ta zbatojmë", ka thënë ai. Avdiu ka mohuar se ka pakënaqësi nga komunat në ndarjen e granteve. "Komunat janë të kënaqura me mënyrën e ndarjes së granteve dhe deri më tash nuk e kemi asnjë vërejtje", ka thënë ai.